



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 24.

Prishtinë, më 03.07.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Rustem Mustafa, Valdete Bajrami, Ilir Deda, Time Kadrijaj, Luljeta Veselaj- Gutaj, Kujtim Paçaku dhe Sllobodan Petroviq.

Munguan: Xhavit Haliti, Vjosa Osmani dhe Arben Gashi.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky:

REND I DITËS

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e datës 15.6.2015;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-22 për Armë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatese të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-15 për Letërnjoftim, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-29 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 7. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-28 për Tatimin në të Ardhurat Personale, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

8. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-37 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

9. Të ndryshme.

Kryetarja pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë hapi mbledhjen sipas rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e datës 15.6.2015;

Kryetarja konstatoi se Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 15.06.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-22 për Armë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja prezantoi opinionin ligjor lidhur me këtë projektligj, duke konstatuar se ai rregullohet me legjislacionin e BE-së dhe lidhur me këtë hapi debatin.

Meqë nuk kishte ndonjë vërejtje në Projektligj dhe Raportin e Komisionit funksional me amendamentet e propozuara, Kryetarja konstatoi se Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji Nr. 05/L-22 për Armë, nuk është në kundërshtim me Legjislacionin e BE-së. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk janë në kundërshtim me parimet bazë të Acquis Communitare.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatese të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë projektligj, duke konstatuar se ai rregullohet me legjislacionin e BE-së dhe lidhur me këtë hapi debatin.

Meqë nuk kishte ndonjë vërejtje në Projektligj dhe Raportin e Komisionit funksional me amendamentet e propozuara, kryetarja konstatoi se njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatese të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri, nuk është në kundërshtim me Legjislacionin e BE-së. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk janë në kundërshtim me parimet bazë të Acquis Communitare.

5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-15 për Letërnjoftim, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja lidhur me këtë ligj paraqiti opinionin ligjor, duke konstatuar se ky projektligj nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së dhe lidhur me këtë hapi debatin.

Ilir Deda pati vërejtje në amendamentin nr. 2, të propozuar nga Nait Hasani. Deda tha se në asnjë mënyrë nuk duhet të pranohet ky amendament, pasi është jashtë praktikave evropiane, kjo nuk është zgjidhje e duhur, dhe nuk është në përputhje me praktikat evropiane që identiteti etnik të shkruhet në letërnjoftim. Komisioni Funkcional e ka përkrahur, por ne nuk duhet ta përkrahim këtë sepse nuk është në përputhje me standardet evropiane, as me praktika evropiane, t'i detyrosh njerëzit të japin identitetin në letërnjoftim, kjo është e papranueshme.

Luljeta Veselaj-Gutaj -Mendoj që nuk është e drejtë të bëhen dallime të tilla, siç e kanë bërë me këtë amendament. Edhe pse nisma ka qenë që të mos ketë keqpërdorime në aplikime të ndryshme, sepse e shfrytëzojnë rastin komuniteti më i madh tek ne të përfitojë nga komunitetet e tjera, kjo ka qenë arsyeja që e kanë marrë iniciativën për këtë amendament, por mendoj që ne nuk duhet ta përkrahim këtë pjesë.

Kujtim Paqaku tha se në asnjë mënyrë nuk duhet të shkruhet me fjalë në letërnjoftim identiteti etnik dhe në asnjë mënyrë shtetasit e Kosovës nuk guxojnë të identifikohen a është ky apo ai, jo të shkruhet me fjalë, në disa raste kemi pasur me numra serik të regjistrimit, ku janë kuptuar të cilit komunitet janë.

Pas diskutimeve **kryetarja** konstatoi se Komisioni me shumicë votash dhe një abstenim nxori këtë ;

Rekomandim

1. Projektligji Nr. 05/L-15 për Letërnjoftim, nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacion të BE-së;
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional, nuk rregullohen në mënyrë specifike me legjislacion të BE-së;
3. Amendamenti Nr. 2 i deputetit Nait Hasani, nuk përkrahet nga Komisioni për Integritet Evropian.

6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-29 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë projektligj, duke konstatuar se rregullohet me legjislacionin e BE-së dhe lidhur me këtë hapi debatin.

Meqë nuk kishte ndonjë vërejtje në Projektligj dhe Raportin e Komisionit funksional me amendamentet e propozuara , **kryetarja** konstatoi se njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligjit Nr. 05/L-29 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, nuk është në kundërshtim me Legjislacionin e BE-së.

Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk janë në kundërshtim me parimet bazë të Acquis Communitare.

7. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-28 për Tatimin në të Ardhurat Personale, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë projektligj, duke konstatuar se ai rregullohet me legjislacionin e BE-së dhe lidhur me këtë hapi debatin.

Meqë nuk kishte ndonjë vërejtje në Projektligj dhe Raportin e Komisionit funksional me amendamentet e propozuara , kryetarja konstatoi se njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji Nr. 05/L-28 për Tatimin në të Ardhurat Personale, nuk është në kundërshtim me Legjislacionin e BE-së.

Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk janë në kundërshtim me parimet bazë të Acquis Communitare.

8. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-37 Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë projektligj, duke konstatuar se ai rregullohet me legjislacionin e BE-së dhe lidhur me këtë hapi debatin.

Meqë nuk kishte ndonjë vërejtje në Projektligj dhe Raportin e Komisionit funksional me amendamentet e propozuara , kryetarja konstatoi se njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligjit Nr. 05/L-37 Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar nuk është në kundërshtim me Legjislacionin e BE-së.

Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk janë në kundërshtim me parimet bazë të Acquis Communitare.

9. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk u ngrit asnjë çështje.

Kryetarja e Komisionit,

E përgatiti :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Znj. Teuta Sahatqija